

Njoftim për Shtyp datë 08 Prill 2025

Datë: 08.04.2025



Sot, më datë 08.04.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli zhvilloi seancën dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. [...] me funksion gjyqtar pranë Gjykatës [...], dhe në përfundim të saj vendosi shpalljen e vendimit më datë 23.04.2025, ora 10:00.

Gjithashtu, Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli miratoi raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares znj. [...], për vitin 2019, si dhe raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit z. [...] për vitin 2021-2023.

Për shkak të rëndësisë së çështjes, Këshilli vendosi të shtojë për shqyrtim projektvendimin:

“Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares znj. Suela Dashi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Në përfundim, Këshilli miratoi vendimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares znj. Suela Dashi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.